

Studentë Universiteti
 në Cilësi Përkushtim
 Risi
VISTAS
 Universiteti Arsim Komunitet Akreditim qendër Aplikim Tradite
 Studenti Alumni shkencor Integrim Sport Kërkim
 Vizion Dije Inovacion Barleti Kontribut
 Botime Mësimdhënie Mediatizim
Marin Ide
Sipërmarrje



UNIVERSITETI
MARIN BARLETI

Viti 2011-2012

TRADITA në Universitetin Marin Barleti përfaqësohet nga personalitetet e shquara akademike të vendit të cilët përbëjnë Bordin që drejton politikën akademike të Universitetit dhe nga një numër i madh profesorësh të mirënjohur botërisht të cilët drejtojnë strukturat akademike të Universitetit Marin Barleti dhe sjellin në auditorët tanë përvojë dhe mençuri të vyer, si trashëgimi për brezat që do të vijnë.

AKREDITIMI i Universitetit Marin Barleti u zyrtarizua nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës në vitin 2009, por procesi i përsosjes dhe përmirësimit

të standarteve akademike është një punë që do të vazhdojë në vijim. Puna e vazhdueshme e Prorektorit Akademik, Dekanëve, Zyrave të Cilësisë dhe Departamenteve garanton diploma cilësore dhe formim që i bën studentët



e këtij Universiteti konkurrentë të denjë në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar të punës.

SIPËRMARRJA është fryma e cila dijet akademike i materializon në iniciativat të prekshme biznesi. Vullneti dhe ambicja që karakterizon njerëzit tanë ilustron nga cilësitë apikative në strukturat Administrative dhe Menaxhuese të Universitetit. Qendrat për Nxitjen dhe Zhvillimin e Biznesit të Vogël dhe të Mesëm, sektori inovativ i Marketingut, Inkubatorët e Ideve për Biznese të Reja janë sfida të hapura për të gjithë studentët tanë të rinj.



A e dinit se ...

Universiteti Marin Barleti ka edhe një Dekan të Studentëve?

Ky pozicion mbahet nga Elona Bano. Kur të vëzitoni në UMB mos harroni të pyesni se cili është roli i Dekanit të Studentëve.

ZGJEDHJA E NJË PROGRAMI STUDIMI

Core Curricula, Çfarë është?

Është një grup lëndësh i hartuar për të siguruar një bazë të gjerë njohurish të studentëve në UMB. Core Curricula zhvillon tiparet themelore akademike dhe intelektuale në fushat përkatëse të studimit. Ajo mundëson dhe pajisjen me njohuri mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit. Core Curricula është një platformë elastike. Ajo i krijon mundësi çdo studenti, që pas një semestri, të ketë mundësi rizgjedhjeje. Formatimi i Core Curiculës afron sistemin e studimeve të këtij Universiteti, me sistemet më të avancuara bashkëkohore.

Minorët

Sipas modelit anglo-sakson të studimeve, minorët janë paketa studimesh të menduara për të prodhuar tek studentët formime dytësore, aplikative, të cilët rrisin shanset e punësimit duke mundësuar përditësimin në përputhje



me zhvillimet në tregun e punës. Minorori ndihmon gjithashtu në hedhjen e një hapi të parë për studimet pasuniversitare pasi studenti në përzgjedhjen e minorit përcakton fushën e tij të interesit.

Studimet Master

Programet e studimit master, paraqiten të domosdoshëm në tregun e sotëm të punës për të gjithë ata që dëshirojnë të përfshihen me sukses në profesionet e ndryshme. Këto programe u ofrohen kryesisht të diplomuarve të cilët kanë përfunduar

studimet universitare në çdo disiplinë akademike dhe synojnë të zhvillojnë më tej karrierën e tyre. Programet e studimit master bëjnë të mundur që pjesëmarrësit të fitojnë aftësi analize dhe praktike dhe ofrojnë gjithnjë e më shumë trajnim për rritjen e ekspertizës në fushat përkatëse.

BURSAT DHE NDIHMA FINANCIARE

Bursa të pjeshme studimi

Për të stimuluar studentët cilësorë dhe për të vlerësuar arritjet e tyre në shkollat e mesme publike dhe jopublike, UMB do të ofrojë edhe për vitin akademik 2011-2012 bursa të pjeshme studimi për studentët me mesatare mbi 8.



Bursa të plota studimi

Bazuar në mesataren e katër viteve të shkollës së mesme UMB ofron bursa të plota njëvjeçare. Studentët që vazhdojnë të ruajnë këto nivele përfitojnë

nga fondi i Rektorit/Dekanit sipas përcaktimeve të parashikuara në statut.

Bursa të plota studimi dhe jetese

UMB, duke treguar përgjegjshmëri të lartë sociale, ofron edhe bursa të plota studimi dhe/ose jetese për ata studentë nga rrethet të cilët kanë rezultate të larta në shkollat e mesme por që kanë vështirësi financiare për të përballuar jetesën në Tiranë.



KËSHILLIMI DHE ORIENTIMI I KARRIERËS

Tutoriali akademik orienton studentët gjatë periudhës studentore dhe i ndihmon ata për të arritur maksimumin e tyre. Staf i akademik i të gjithë departamenteve të Universitetit vihet në shërbim të studentëve për t'ua lehtësuar atyre barrën e studimeve me tutoriale të individualizuara sipas nevojave të secilit.

Zyra për Këshillimin dhe Karrierën

Është struktura bazë e cila mundëson informacionin dhe këshillimin ndaj individëve që interesohen të ndjekin studimet pranë UMB-së dhe studentëve aktualë. Kjo zyrë është projektuar për të mbështetur edhe më tej karrierën e studentëve pas diplomimit si dhe për të vendosur dhe ruajtur lidhje të ngushta me të gjithë të diplomuarit në UMB.

Shërbimet e gjetjes së vendeve të punës

Zyra e Këshillimit dhe Karrierës organizon çdo vit javën e karrierës duke trajnuar studentët për përgatitjen e CV-ve të tyre, prezantimin gjatë aplikimeve për punë, etj. Zyra ka vendosur lidhje me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë duke lehtësuar ndërmjetësimin e punësimit të studentëve, sikundër edhe me biznese të veçanta. Gjithashu, pjesë e aktiviteve të kësaj zyre janë dhe përfshirja e Universitetit dhe studentëve në Panairt e punësimit.

Rrjeti Alumni

Zyra për Këshillimin dhe Karrierën është projektuar dhe për të vendosur dhe ruajtur lidhje të ngushta me të gjithë studentët e diplomuar në UMB. Kjo do të shërbejë jo vetëm për



mbështetjen e mëtijshme të tyre, por edhe për përfshirjen e tyre sa më efektive në zhvillimin e mëtijshëm të universitetit dhe studentëve të tij aktualë.

Buletini profesional

Buletini profesional është një nga mjetet që UMB vë në dispozicion të të diplomuarve me eksperiencë pune. Nëpërmjet këtij shërbimi, institucione dhe biznese të ndryshme seleksionojnë CV – të në fusha të ndryshme profesionale si marketing, burimet njerëzore, financa, sektorët jo fitimprurës, konsulenca ligjore, etj.

STUDENTI NË QENDËR

Jeta studentore

Kampusi i universitetit Marin Barleti ndodhet pranë Parkut të Madh të Tiranës në njërin nga zonat më të gjalla të kryeqytetit. Stafi i Universitetit dhe vetë studentët organizojnë në mënyrë të rregullt aktivitete jashtëshkollore,



mbremje festive, ekskursione, organizime sportive si dhe udhëtime brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Unioni Studentor

Unioni studentor përbën përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në mirëdrejtimin e universitetit dhe organizimin e jetës studentore. U.S. është i përbërë nga përfaqësues të zgjedhur nga studentët për secilin program studimi. Ai siguron përfaqësimin e studentëve në strukturat akademike të universitetit (Senat) dhe në struk-

tura të tjera. Organizon veprimtari të shërbimeve studentore, koordinon aktivitetet e studentëve për klubet dhe shoqatat.

SHËRBIME PËR STUDENTËT

Biblioteka

Në kohën që ju jeni student i UMB-së keni të gjitha mundësitë që të shpenzoni pjesën më të madhe të kohës tuaj të studimit në ambjentet e bibliotekës së universitetit. Atje mund të shfrytëzoni titujt por edhe revistat dhe gazetat në të cilat është i abonuar Universiteti si Wall Street Journal , The Economist etj.



Shërbimet e informatikës akademike

Universiteti mundëson infrastrukturë të teknologjisë së informacionit. Në ambjentet kryesore të UMB-së ndodhet një kabinet kompjuterash të

cilët mund të përdoren nga studentët në çdo kohë. Përveç kompjuterave desktop, UMB ofron përdorimin e kompjuterave Lap top të cilët gjithashtu mund të përdoren prej studentëve edhe në rrjetin wireless.

Universiteti Marin Barleti ju ofron mundësinë e mësimit të Gjuhëve Moderne. Pedagogët tanë kanë një eksperiencë të gjatë në fushën e mësimit të këtyre gjuhëve. Universiteti ju mundëson veçanërisht perfeksionimin e gjuhës angleze, pavarësisht se në cilat fusha studimi jeni të fokusuar. Motoja jonë është "Anglishtja për të gjithë".

Teknologjitë e mësimit në auditorë dhe shërbimet e mediave

Mësimit konsiston në një kombinim të leksioneve me seminare, ku studentët kanë mundësi të diskutojnë, të bëjnë pyetje, të bashkëbisedojnë me stafin akademik, por njëkohësisht dhe të paraqesin punime e kërkime, vrojtime, studime e projekte të përgatitura individualisht ose në grup, të mbështetur këto dhe me teknologji të informacionit.

Kafeteria: Pjesë e kampusit të Universitetit Marin Barleti është dhe kafeteria, e cila ofron ushqim dhe pije për studentët dhe stafin me çmime të reduktuara.

Sallë kinemaje: Në ambjentet e universitetit në mënyrë të programuar projektohen filma të rinj ose filmat klasikë që kanë bërë historinë e kinematografisë, falas për të gjithë studentët e UMB.

Karta e studentit: Karta e studentit me të cilën pajisen studentët në UMB u ofron atyre ndër të tjerave edhe ulje të ndryshme në ato subjekte apo institucione si: restorante, librari, palestra etj. me të cilat UMB ka marrëveshje bashkëpunimi.

Libraria, fotokopje: Në ambjentet e UMB gjendet gjithashtu edhe një librari e cila përman libra akademike dhe



artistikë, shërbimin e printimit dhe fotokopjes si dhe shërbimeve të tjera kancelarike.

KLUBET STUDENTORE

Klubi Debat dhe Demokraci (DiDi), udhëhiqet nga pedagogu Erion Kristo dhe studentët që kanë shprehur vullnetin e tyre për bashkëpunim, i cili synon të rrisë pjesëmarrjen e studentëve dhe informimin e tyre në fushën e demokracisë dhe debateve nga i cili zhvillohet aftësia e të menduarit dhe të gjykuarit kritik.



Klubi Ligj dhe Demokraci, udhëhiqet nga pedagogia Edlira Lloha. Qëllimi primar është zgjerimi i kulturës juridike kryesisht tek studentët e Universitetit Marin Barleti, por edhe më gjerë, nëpërmjet interpretimit të jurisprudencës së gjykatave shqiptare por

edhe të atyre ndërkombëtare, si dhe nëpërmjet organizimit të eventeve mbi diskutimin e tendencave të ligjit dhe të shtetit të së drejtës.

Klubi Media dhe Teknologjitë e Reja udhëhiqet nga pedagogu Blendi Salaj. Ky klub studentor përmes bashkëpunimeve do të ndihmojë studentët të zhvillojnë talentin në fushën mediatike duke i përfshirë ata në përvoja praktike në morinë e larmishme të mediave dhe teknologjive më të reja.

Një tjetër klub është **Student Entrepreneurship Club (Klubi i Sipërmarrjes Studentore)** dhe udhëhiqet nga Jorge Kovaçi dhe studentët e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, të cilët besojnë në sigurimin e mbështetjes të çdo ideje novatore nga çdo rajon në zhvillim e sipër dhe që nëpërmjet angazhimit të klubit në format dhe mënyrat më efikase të mundësojë vënien në jetë të idesë duke ndikuar kështu në



zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Ky klub është një laborator për studentët dhe të diplomuarit me prirje dhe interesa sipërmarrëse të cilët duan të realizojnë idetë e tyre.

Dhe së fundmi **Klubi Bota Studentore.** Ky klub ka një veçanti në llojin e tij: Ajo është mbështetja e klubeve të tjera aktive dhe ekzistuese. Po ashtu Klubi koordinon dhe mbikqyr aktivitetet e tyre në mënyrë që të formojë një "guidë" për studentët për sa kohë ata ndodhen brenda kampusit universitar si aktorët kryesorë të kësaj Bote Studentore me të cilët dhe për të cilët janë krijuar këto organizma.

Na ndiqni në:



www.umb.edu.al

Në vëmendje:

Qendra e Mediave të Reja dhe Teknologjisë
(Center for New Media and Technology)

Qendra e Mediave të Reja dhe Teknologjisë është një organizëm i Universitetit Marin Barleti. Në këtë qendër japin kontributin e tyre përmes bashkëpunimit, disa nga gazetarët më në zë, si dhe profesionistë të shuar nga grupe mediatike dhe kompani teknologjike.

Qendra është organizmi ideal për të ndërtuar dhe forcuar marrëdhëniet midis studentëve dhe lojtarëve kryesorë të tregut mediatik.

Përmes botimeve, realizimeve radiotelevizive dhe eventeve të ndryshme të organizuara nga Qendra për Mediat e Reja dhe Teknologjinë, Qendra u jep studentëve mundësinë të zgjerojnë rrjetin e njohjeve ndër profesionistë të fushës për të zhvilluar qysh në vitet e shkollës karrierën e tyre të ardhme.



1. Kampusi Qendror



2. Kampusi i Studimeve Master

Partnerët:

VODAFONE, BKT, CAPITAL, SIGAL, UNION BANK,
 VENETO BANKA, ANDE - Im, AMF ALBANIA,
 HAKANI & ASSOCIATES, TONUCCI AND PARTNERS, INTESA SAN
 PAOLO, BOTIMET DUDAJ, SHKOLLA KOMBËTARE E NOTERËVE,
 CENTURY 21, KESH, SIGN A RAMA, HOTEL ADRIATIK, ECPR,
 KALO & ASSOCIATES, JETA, MEDIALB,
 APA Marketing & Communication, WEBSTER UNIVERSITY.

Harta e Tiranës / Vendndodhja



BACHELOR

1. FINANÇË KONTABILITET*
me E DREJTË BIZNESI
2. FINANÇË KONTABILITET
me E DREJTË BIZNESI
3. MENAXHIM BIZNESI*
4. MENAXHIM me
E DREJTË BIZNESI
5. ADMINISTRIM BIZNESI*
6. INFORMATIKË *
7. JURIST I PËRGJITHSHËM*
8. JURIST I PROFILIZUAR në:
E Drejtë Tregtare
E Drejtë Penale
E Drejtë Civile
9. POLITOLOG në profilet:
I përgjithshëm
Adminstrim publik
Lidship
10. PSIKOLOG*
11. SOCIOLOG*

*MINORËT (formime dytësore):

- Ekonomiks
- Shërbime bankare
- Shpërndarje dhe shitje
- Turizëm dhe udhëtime
- Marketing
- Menaxhim
- Teknologji e Informacionit
- Shkenca kompjuterike
- Rrjete dhe sisteme dixhitale
- Administrim publik
- Burime njerëzore
- Komunikim
- Psikologji sociale
- E drejtë biznesi

MASTER SHKENCOR:

KONTABILITET - FINANÇË

Menaxhim Financiar
Shërbime Financiare & Bankare
Taksimi dhe Ligji
Kontabilitet

MENAXHIM BIZNESI

Logjistikë dhe Menaxhim Operacional
Marketing Strategjik
Menaxhim i Burimeve Njerëzore
Menaxhim i Sistemeve të Informacionit

ADMINISTRIM PUBLIK

Administrativ-Ligjor
Administrativ-Ekonomik

STUDIME EVROPIANE

Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe
Diplomaci
Politikat Evropiane dhe Administrimi
Publik
Studime Ekonomike Evropiane
E Drejtë Evropiane

KOMUNIKIM

Studime në Gazetari
Komunikim/Studime në Gazetari
Ndërkombëtare
Komunikim/Marrëdhënie me Publikun
në Nivel Ndërkombëtar

EDUKIM

Mësimdhënia dhe të Nxënërit
Drejtimi dhe Administrimi në Arsimit

ZHVILLIM I QËNDRUESHËM

Qeverisja dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm

SHKENCA JURIDIKE

E Drejtë Publike
E Drejtë Tregtare

MASTER PROFESIONAL (EKZEKUTIV):

ADMINISTRIM BIZNESI

Financë-Kontabilitet
Shërbime Bankare Financiare
Marketing dhe Menaxhim Operacionesh
Lidership dhe Menaxhim i Burimeve
Njerëzore

ADMINISTRIM PUBLIK

Administrim Publik

KOMUNIKIM

Gazetari Ekonomike
Komunikim Publik

STUDIME EVROPIANE

Master në Studime Evropiane

EDUKIM

Mësimdhënia dhe të Nxënërit
Drejtimi dhe Administrimi në Arsimit

SHKENCA JURIDIKE

E Drejtë Publike
E Drejtë Tregtare



UNIVERSITETI
MARIN BARLETI

Adresa:

Universiteti Marin Barleti
Rr. " Sami Frashëri", Nr. 41, Tiranë
www.umb.edu.al

Info

Tel: 04 24 30 333
04 22 52 621
Fax: 04 22 50 911
Cel.: 069 20 67 247
069 20 62 086

info@umb.edu.al
master@umb.edu.al

Pranime

pranimi@umb.edu.al

Marrëdhënie Publike

Tel: 04 24 30 142
media@umb.edu.al

Marketing

Tel: 04 24 30 142
marketing@umb.edu.al

** Çdo informacion në këtë broshurë është korrekt deri në momentin që ky material shkon për botim (Prill 2011).